32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin e impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 242-21-4519-5-1-1/C246

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e shumës së kontratës për periudhën 120 ditë.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve: Përgjegjësi e OE; (b) Për Humbje ose dëmtim të Pajisjeve: Përgjegjësi e OE; (c) Për Humbje ose dëmtim të pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën: Përgjegjësi e OE (d) Për dëmtim personal ose vdekje: Përgjegjësi e OE (a) (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: Përgjegjësi e OE (ii) të personave të tjerë: Përgjegjësi e OE
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <i>[shëno numrin]</i> ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë pas nënshkrimit të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë sipas planit dinamik të ofruar nga OE ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë përgjegjësi e OE. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët do të definohet nga Komisioni AK.
Regjistri i punës	20.1	Ditari i punimeve.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me Vendim nga AK
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: Për veq sigurimit të ekzekutimit prej 120.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë sipas planit dinamik ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuere e defekteve është 365 ditë, të sille Deklarata si dëshmi për Periudhën Garantuere,
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <i>[shëno përqindjen]</i> .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Përgjegjësi e zgjidhjes miqësore e mosmarrëveshjes është Departamenti i Prokurimit në koordinim me Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<i>[shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [specifikoni gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

LOT - 6 -

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE - PARAMASA DHE PARALLOGARIA E RENOVIMIT TË OBJEKTEVE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS -					
- RENOVIMI I OBJEKTE TE FAKULTETIT TE SHKENCAVE - DEPARTAMENTI I FIZIKES					
Nr.	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI PËR TOTAL ME TVSH €
I PUNËT E DEMOLIMIT					
1	Largimi i inventarit nga sallat ,kabintet e ndryshme brenda objektit (karrige te ndryshme ,tavolinatc ndryshme,dollape te ndryshme,orman , krevat, kuzhine, ulseve kolltukeve etj) ruajtja dhe kthimi i inventarit ne gjendjen e meparshme pas perfundimit te punimeve. Qmimi te llogaritet per nje hapsire ne m2 (Dhome, Klase, Salle, Amfiteater etj).	m ²	85.00	0.10 €	8.50 €
6	Demolimi i llajsneve perimetrike te drurit te Parketit dhe Laminatit. Transporti i materialit ne mbeturina te qytetit deri 15km	m'	64.00	0.10 €	6.40 €
10	Demolimi i dyshemese nga Parketi komplet me ngjites , gerryerja e deri ne shtresen e estrihut. Transporti i materialit ne depon e mbeturinave te qytetit deri 15km	m ²	85.00	0.10 €	8.50 €
14	Demolimi i ESTRIH-ut ne dysheme te hapësirave te brendeshme deri ne trashesin t=10.00cm komplet me shtresat e folies , dhe steropolit . Demolimi te realizohet deri ne shtresen e betonit. Transporti dhe hudhja ne mbeturina legale te qytetit deri 15km	m ²	85.00	0.10 €	8.50 €
64	Demolimi sanitarise si : wc guaskave me rezervar, lavamave, pisuareve , bojlerave , pasqyreve , mbajtjesve te letrave higjenike , tharase te duarve. Transporti i materialit ne deponin me te afert legale deri ne 15km	cope	1.00	15.00 €	15.00 €
65	Demolimi i aksesoreve te sanitarise si: Gypa fleksibil , ek-ventilla , ventilfat e sistemit te ujit , kutise shperndarese. Transporti i materialit deri ne deponin me te afert legale.	cope	1.00	15.00 €	15.00 €
TOTALI - I- (1-126)					61.90 €
Verejteje: Te gjitha demolimet dhe materialet e demoluara duhet te dergohen deri ne deponi ku e ka percaktuar Organi Mbikqyresë.					
II PUNËT PËRGATITORE					
1	Pastrimi i komplet hapësirës ku do te zhvillohen punimet. Te parashihet pastrimi nga pluhuri, vazot me gjelbrim te ndryshem etj, ne hapësirat e brendshme dhe jashtme.	m ²	85.00	0.10 €	8.50 €
4	Izolimet tjera me folie PVC si: Dritare, dyer, radiatora , kompjutera,kamcra, serveret,gardhet e shkalleve dhe ballkoneve.	m2	85.00	0.50 €	42.50 €
17	Punimi i dokumentacionit teknik – sipas realizimit ("As Build").	m ²	85.00	1.00 €	85.00 €
TOTALI -II- (1-17)					136.00 €
VIII PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT					
12	Furnizimi me material,punimi dhe vendodja e Stiroporrit t=2+2 cm , folie pvc, si material termoizolues ne dysheme te ndryshme. Aplikimi behet vetem sipas nevojës kur dyshemeja mbulohet me konstrukcion druri.	m2	85.00	4.00 €	340
TOTALI -VIII- (1-11)					340.00 €
IX PUNËT E DYSHEMESE					
5	Furnizimi transporti dhe vendosja e "LAMINATIT" , trashesia t = 8mm, me foli adekuate per dysheme.Modelin, Ngjyren dhe nuancen e percakton organi mbikqyres.	m ²	85.00	10.00 €	850.00 €
6	Furnizimi me material, vendosja e llajsneve te laminatit me t=4cm ne tere perimetrin e kthines. Ngjra dhe tekstura sipas aprovimit te org.mbikeqyres.	m'	64.00	1.50 €	96.00 €
14	Furnizimi transporti me material dhe shtruarja e shtresës rrafshuese estrih beton: përzierje 1:3 çimentos/rërë duke përdorur rërën e lumit, trashësia e shtresës rrafshuese shkon 5-7 cm, te jete i armuar me fibra .	m ²	85.00	7.00 €	595.00 €
TOTALI - IX- (1-17)					1,541.00 €




XVII	PUNËT E UJËSJELLESIT KANALIZIMIT ,HIDRANTËVE DHE SANITARISË - Punët e dheut- INSTALIMET E KANALIZIMIT-PAISJET SANITARE-				
106	Furnizimi, transporti dhe montimi i guacave,komplet me fontana, gypëzimin dhe unazat lidhëse, në çmim të përfshihen letër toalti, shporta për mbeturina si dhe brusha.	copë	1.00	150.00 €	150.00 €
TOTALI - XVII- (1-110)					150.00

RAKAPITULACIONI

NR.	PËRSHKRIMI	VLERA TOTALE E ÇMIMEVE PËR NJËSI ME TVSH
I	ARKITEKTURA- PUNËT E DEMOLIMIT (1-129)	61.90 €
II	ARKITEKTURAPUNËT PËRGATITORE (1-22)	136.00 €
VIII	ARKITEKTURA - PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT (1-11)	340.00 €
IX	ARKITEKTURA - PUNËT E DYSHEMESË (1-19)	1,541.00 €
XVII	PUNËT E UJËSJELLESIT KANALIZIMIT ,HIDRANTËVE DHE SANITARISË - Punët e dheut- INSTALIMET E KANALIZIMIT-PAISJET SANITARE-(1-111)	150.00 €
TOTALI I ÇMIMIT PËR TOTAL		2,228.90 €

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE - PARAMASA DHE PARALLOGARIA E RENOVIMIT TË OBJEKTEVE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS -
- RENOVIMI I OBJEKTE TE FAKULTETIT TE SHKENCAVE - DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS

Nr.	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI PËR TOTAL ME TVSH €
I	PUNËT E DEMOLIMIT				
1	Largimi i inventarit nga sallat ,kabintet e ndryshme brenda objektit (karrige te ndryshme ,tavolinate ndryshme,dollape te ndryshme,orman ,krevet, kuzhine, ulseve kolltukeve etj) ruajtja dhe kthimi i inventarit ne gjendjen e meparshme pas perfundimit te punimeve. Qmimi te llogaritet per nje hapsire ne m2 (Dhome, Klase, Salle, Amfiteater etj).	m ²	158.00	0.10 €	15.80 €
6	Demolimi i llajsneve perimetrike te drurit te Parketit dhe Laminatit. Transporti i materialit ne mbeturina te qytetit deri 15km	m ³	120.00	0.10 €	12.00 €
10	Demolimi i dyshemese nga Parketi komplet me ngjites , gerryerja e deri ne shtresen e estrihut. Transporti i matrcialit ne depon e mbeturinave te qytetit deri 15km	m ²	158.00	0.15 €	23.70 €
14	Demolimi i ESTRIH-ut ne dysheme te hapësirave te brendeshme deri ne trashesin t=10.00cm komplet me shtresat e folies , dhe steropollit . Demolimi te realizohet deri ne shtresen e betonit. Transporti dhe hudhja ne mbeturina legale te qytetit deri 15km	m ²	158.00	0.10 €	15.80 €
30	Demolimi ,gryerja "pjeserisht" e shtreses se gletit si dhe pastrimi i mureve dhe pllafoneve nga mbetjet e patinimit. Kalulimi te behet komplet m2 te hapësires se mureve dhe tavaneve .Transporti i materialit ne deponin me te afert legale deri 15 km	m2	95.00	0.10 €	9.50 €
32	Gryerja e shtreses se ngjyres me leter grrithese adekuate si dhe pastrimi i mureve dhe pllafoneve nga mbetjet e ngjyres.	m ²	95.00	0.10 €	9.50 €
40	Demolimi i dyerc ekzistuese te brendshme te drurit. Transporti i materialit ne deponin me te afert legale deri 15km	m2	2.00	5.00 €	10.00 €
TOTALI - I- (1-126)					96.30 €
Verejteje: Te gjitha demolimet dhe materialet e demoluara duhet te dergohen deri ne deponi ku e ka percaktuar Organi Mbikqyresë.					
II	PUNËT PËRGATITORE				



1	Pastrimi i komplet hapësirës ku do të zhvillohen punimet. Të parashihet pastrimi nga pluhuri, vazot me gjelbrim të ndryshëm etj. në hapësirat e brendshme dhe jashtme.	m ²	253.00	0.10 €	25.30 €
4	Izolimet tjera me folie PVC si: Dritare, dycer, radiatora , kompjutera,kamera, serveret,gardhet e shkalleve dhe ballkoneve.	m ²	253.00	0.10 €	25.30 €
17	Punimi i dokumentacionit teknik – sipas realizimit ("As Build").	m ²	253.00	1.00 €	253.00 €
TOTALI -II- (1-17)					303.60 €
VI PUNËT E MURATIMIT DHE PUNËT E PLLAFONIT					
8	Furnizimi me material,transporti dhe punimi i geberiteve të WC guacave me "Knauf" të gjelbert kundër lagështisë. Me tegjitha profilet metalike UD,CD dhe elementet percjellese si bulona etj.	m ²	55.00	18.00 €	990.00 €
TOTALI - VI- (1-18)					990.00 €
VIII PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT					
12	Furnizimi me material,punimi dhe vendosja e Stiroporrit t=2+2 cm , folie pvc, si material termoizolues në dysheme të ndryshme. Aplikimi behet vetëm sipas nevojës kur dyshemeja mbulohet me konstrukcion druri.	m ²	158.00	4.00 €	632.00 €
28	Punimi i izolimit termik perimetrik i instalimeve të ujit dhe kanalizimit.	M'	25.00	4.00 €	100.00 €
TOTALI -VIII- (1-11)					732.00 €
IX PUNËT E DYSHEMESË					
1	Furnizimi,transporti dhe pergatitja e dyshemesë per EPOKSID në keto shtresa: Gerryerja e betonit me makine me stera metalike, mbushja e ditatimeve dhe plasaritjeve me llaq epoksid, si dhe riparimet e gropezave eventuale etj. Furnizimi dhe shtrirja e primerit (bazës) epoksid në trashësi 1.0 mm të cilin duhet të shtohet rërë kuarci me fraksion 0.3-0.8 mm si dhe miell kuarci. Furnizimi dhe mbushja e dyshemesë me rërë kuarci me fraksion 0.3-0.8 derisa dyshemeja është ende në gjendje të lëngët e cila e ngritë nivelin në min. 1.5 mm Furnizimi dhe shtrirja e epoksidit me ngjyrë vetenivelizues me ngjyrë simbas zgjedhjes së projektuesit me trashësi 2.0 mm si dhe hudhja e fluskave dekorative (çipsat). Furnizimi dhe shtrirja e shtresës mbrojtëse (llak transparent) Anti gervishtje e cila duhet të kombinohet me qelq të bluar. Prerja e dilatimeve me makine speciale dhe mbushja e tyre me stuko poliuretani. Ngjyra dhe Nuanca percaktohet nga organi mbikqyres.	m ²	32.00	22.00 €	704.00 €
2	Punimi i skajoreve (llajsneve) me rërë kuarci dhe epoksidit me lartësi prej 4.0 deri 6.0 cm.	m'	29.00	3.00 €	87.00 €
5	Furnizimi transporti dhe vendosja e "LAMINATIT" , trashësia t = 8mm, me foli adekuate për dysheme.Modelin, Ngjyren dhe nuancen e percakton organi mbikqyres.	m ²	126.00	10.00 €	1,260.00 €
6	Furnizimi me material, vendosja e llajsneve të laminatit me t=4cm në tere perimetrin e kthines. Ngjyra dhe tekstura sipas aprovimit të org.mbikeqyres.	m'	91.00	2.00 €	182.00 €
14	Furnizimi transporti me material dhe shtruarja e shtresës rrafshuese estrih beton: përzierje 1:3 çimentos/rërë duke përdorur rërën e lumit, trashësia e shtresës rrafshuese shkon 5-7 cm, të jetë i armuar me fibra .	m ²	158.00	6.00 €	948.00 €
TOTALI - IX- (1-17)					3,181.00 €
X PUNË E ZDRUKTHTARISË					



8	Fabrikimi, sjellja dhe montimi i derës se "drurit" me kornizë nga druri dhe paneli nga druri, me dimensione te ndryshme. Kalulimi te behet per m2, masat mirren ne vend. Dy dyer 80x210 cm	m2	3.36	180.00 €	604.8
TOTALI -X- (1-28)					604.80 €

XI PUNËT E SUVATIMIT DHE FASADËS					
1	Furnizimi me material dhe lyerja e mureve me "contact-beton". Aplikimi i mases me uje sipas udhezimeve te prodhuesit	m ²	95.00	0.10 €	9.50 €
2	Sjellja e materialit dhe vendosja e rrjetes rabc ne kendet ku bashkohet betoni dhe blloku. Aplikimi sipas udhezimeve te prodhuesit te suvatimit.	m ²	95.00	0.50 €	47.50 €
4	Furnizimi me material, vendosja e llajsneve te metalit ne kende para se te kryhen suvatimet.	m'	30.00	1.00 €	30.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe Suvatimi dhe rregullimi i shpaletave te dycerve, dritareve, shtylla, mure dhe hapjeve ne brendesi te objektit ku gjinden pozicione te shpaletave me gjersi d = 15-30 cm, me llaç gipsi MP 75 në trashësi prej 1.5-2 cm. Ne pozicion të parashihet vendosja e këndoreve metalike në kendet e mureve.	m'	12.00	5.00 €	60.00 €
8	Furnizimi me material, transporti dhe patinimi me "glet" mase I shpaletave te dycerve dhe dritareve , ne hapesirat e brendeshme te objektit . Aplikimi I ne dy shtresa -d=15-65cm	m'	12.00	2.00 €	24.00 €
10	Furnizimi me material, patinimi i mureve me "GLET" mase ne dy shtresa.	m ²	95.00	3.00 €	285.00 €
11	Furnizimi me material, patinimi i tavaneve me "GLET" mase ne dy shtresa. Aplikimi i mases glet-uje sipas instruksioneve te prodhuesit.	m ²	95.00	3.00 €	285.00 €
12	Geryerja e shtreses se gletit ne murc dhe tavane me leter grrithese adekuate pas gletimit deri ne arrijten e nje shtrese te nje trajteshme te rrafshet, pastrimi dhe pregaditja per shtresat tjera	m ²	95.00	0.10 €	9.50 €
14	Furnizimi me material, patinimi i mureve dhe tavaneve me suvatim "MP75" - "pjeserisht" sipas nevojës ne dy shtresa. Aplikimi i mases MP75-uje sipas instruksioneve te prodhuesit. Llogarina ne m2 te tere hapesirës se gletuar pjeserisht.	m ²	15.00	1.00 €	15.00 €
18	Furnizimi, transporti dhe Ngjyrosja e mureve dhe tavaneve te brendshme me ngjyrë speciale te nuancuar pikment ekologjike, neper vendet e caktuara ku kerkohet me rekomandime.Ngjyra dhe Nuanca percaktohet nga organi mbikqyres.	m ²	95.00	1.00 €	95.00 €
TOTALI - XI- (1-38)					860.50 €

RAKAPITULACIONI

NR.	PËRSHKRIMI	VLERA TOTALE E ÇMIMEVE PËR NJËSI ME TVSH
I	ARKITEKTURA- PUNËT E DEMOLIMIT (1-129)	96.30 €
II	ARKITEKTURAPUNËT PËRGATITORE (1-22)	303.60 €
VI	ARKITEKTURA - PUNËT E MURATIMIT DHE PUNËT E PLLAFONIT (1-23)	990.00 €
VIII	ARKITEKTURA - PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT (1-11)	732.00 €
IX	ARKITEKTURA - PUNËT E DYSHEMESË (1-19)	3,181.00 €
X	ARKITEKTURA - PUNËT E ZDRUKHTARISË (1-28)	604.80 €
XI	ARKITEKTURA - PUNËT E SUVATIMIT DHE FASADËS (1-53)	860.50 €
TOTALI I ÇMIMIT PËR TOTAL		6,768.20 €



**PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE - PARAMASA DHE PARALLOGARIA E RENOVIMIT TË OBJEKTEVE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS -
- RENOVIMI I OBJEKTEVE TË FAKULTETIT TË SHKENCËVE - DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË**

Nr.	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSHI €	ÇMIMI PËR TOTAL ME TVSH €
I	PUNËT E DEMOLIMIT				
1	Largimi i inventarit nga sallat ,kabintet e ndryshme brenda objektit (karrige te ndryshme ,tavolinate ndryshme,dollape te ndryshme,orman , krevat, kuzhine, ulseve kolltukeve etj) ruajtja dhe kthimi i inventarit ne gjendjen e meparshme pas perfundimit te punimeve. Qmimi te llogaritet per nje hapsire ne m2 (Dhome, Klase, Salle, Amfiteater etj).	m ²	115.00	0.10 €	11.50 €
2	Demolimi -grryerja e dyshemes nga materiali EPOX-it ne hapsirat e ndryshme. Demolimi te realizohet deri ne shtresen e estrikut.	m ²	65.00	0.10 €	6.50 €
14	Demolimi I ESTRITIT-ut ne dysheme te hapësirave te brendshme deri ne trashesin t=10.00cm komplet me shtresat e folies , dhe steropolit . Demolimi te realizohet deri ne shtresen e betonit. Transporti dhe hudhja ne mbeturina legale te qytetit deri 15km	m ²	65.00	0.10 €	6.50 €
30	Demolimi ,grryerja "pjeserisht" e shtreses se gletit si dhe pastrimi I mureve dhe pllafoneve nga mbetjet e patinimit. Kalulimi te behet komplet m2 te hapësirës se mureve dhe tavaneve .Transporti I materialit ne deponin me te afert legale deri 15 km	m2	185.00	0.05 €	9.25 €
32	Grryerja e shtreses se ngjyres me leter grrithese adekuate si dhe pastrimi I mureve dhe pllafoneve nga mbetjet e ngjyres.	m ²	185.00	0.05 €	9.25 €
TOTALI -I- (1-126)					43.00 €
Verejteje: Te gjitha demolimet dhe materialet e demoluara duhet te dergohen deri ne deponi ku e ka perezaktuar Organi Mbikqyresë.					
II	PUNËT PËRGATITORE				
1	Pastrimi i komplet hapësirës ku do te zhvillohen punimet. Te parashihet pastrimi nga pluhuri, vazot me gjelbrim te ndryshem etj, ne hapësirat e brendshme dhe jashtme.	m ²	300.00	0.10 €	30.00 €
4	Izolimet tjera me folie PVC si: Dritare, dyer, radiatora , kompjutera,kamera, serveret,gardhet e shkalleve dhe ballkoneve.	m2	300.00	0.10 €	30.00 €
17	Punimi i dokumentacionit teknik – sipas realizimit ("As Build").	m ²	300.00	1.00 €	300.00 €
TOTALI -II- (1-17)					360.00 €
VI	PUNËT E MURATIMIT DHE PUNËT E PLLAFONIT				
8	Furnizimi me material,transporti dhe punimi i geberiteve te WC guacave me "Knauf" te gjelbert kunder lageshtise. Me tegjitha profilet metalike UD,CD dhe elementet perezjellose si bulona etj.	m ²	65.00	18.00 €	1,170.00 €
TOTALI -VI- (1-18)					1,170.00 €
VIII	PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT				
12	Furnizimi me material,punimi dhe venodja e Stiroporrit (t=2+2 cm , folie pvc, si material termoizolues ne dysheme te ndryshme. Aplikimi behet vetem sipas nevojës kur dyshemeja mbulohet me konstrukcion druri.	m2	65.00	4.00 €	260.00 €
28	Punimi i izolimit termik perimetrik i instalimeve të ujit dhe kanalizimit,	M'	35.00	2.00 €	70.00 €
TOTALI -VIII- (1-11)					330.00 €
IX	PUNËT E DYSHEMESË				



1	Furnizimi, transporti dhe pergatitja e dyshemese per EPOKSID ne keto shtresa: Gerryerja e betonit me makine me sfera metalike, mbushja e dilatimeve dhe plasaritjeve me llaç epoksid, si dhe riparimet e gropezave eventuale etj. Furnizimi dhe shtrirja e primerit (bazës) epoksid ne trashesi 1.0 mm të cilit duhet ti shtohet rërë kuarci me fraksion 0.3-0.8 mm si dhe miell kuarci. Furnizimi dhe mbushja e dyshemesë me rërë kuarci me fraksion 0.3-0.8 derisa dyshemeja është ende në gjendje të lëngët e cila e ngritë nivelin ne min. 1.5 mm Furnizimi dhe shtrirja e epoksidit me ngjyrë vetenivelizues me ngjyre simbas zgjedhjes se projektuesit me trashesi 2.0 mm si dhe hudhja e fluskave dekorative (çipsat). Furnizimi dhe shirirja e shtreses mbrojtese (llak transparent) Anti gervishtje e cila duhet te kombinohet me qelq te bluar. Prerja e dilatimeve me makine speciale dhe mbushja e tyre me stuko poliuretani. Ngjyra dhe Nuanca percaktohet nga organi mbikqyres.	m ²	65.00	22.00 €	1,430.00 €
2	Punimi i skajoreve (llajsneve) me rërë kuarci dhe epoksidit me lartesi prej 4.0 deri 6.0 cm.	m ¹	54.00	2.00 €	108.00 €
14	Furnizimi transporti me material dhe shtruarja e shtresës rrafshuese estrih beton: përzierje 1:3 çimentos/rërë duke përdorur rërën e lumit, trashësia e shtersës rrafshuese shkon 5-7 cm, te jete i armuar me fibra .	m ²	54.00	8.99 €	485.46 €
TOTALI - IX- (1-17)					2,023.46 €

XI PUNËT E SUVATIMIT DHE FASADËS					
1	Furnizimi me material dhe lyerja e mureve me "contact-beton". Aplikimi I mases me uje sipas udhezimeve te prodhuesit	m ²	250.00	0.10 €	25.00 €
2	Sjellja e materialit dhe vendosja e rrjetes rabc ne kendet ku bashkohet betoni dhe blloku. Aplikimi sipas udhezimeve te prodhuesit te suvatimit.	m ²	250.00	0.50 €	125.00 €
4	Furnizimi me material, vendosja e llajsneve te metalit ne kende para se te kryhen suvatimet.	m ¹	55.00	1.00 €	55.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe Suvatimi dhe rregullimi i shpaletave te dyerve, dritareve, shtylla, mure dhe hapjeve ne brendesi te objektit ku gjinden pozicione te shpaletave me gjersi d = 15-30 cm, me llaç gipsi MP 75 në trashësi prej 1,5-2 cm. Ne pozicion të parashihet vendosja e këndoreve metalike në kandet e mureve.	m ¹	38.00	4.00 €	152.00 €
8	Furnizimi me material, transporti dhe patinimi me "glet" mase I shpaletave te dyerve dhe dritareve , ne hapesirat e brendeshme te objektit . Aplikimi I ne dy shtresa -d=15-65cm	m ¹	38.00	3.00 €	114.00 €
10	Furnizimi me material, patinimi I mureve me "GLET" mase ne dy shtresa.	m ²	250.00	3.00 €	750.00 €
11	Furnizimi me material, patinimi I tavaneve me "GLET" mase ne dy shtresa. Aplikimi I mases glet-uje sipas instruksioneve te prodhuesit.	m ²	250.00	3.00 €	750.00 €
12	Gerryerja e shtreses se gletit ne mure dhe tavane me leter grrithese adekuate pas gletimit deri ne arrijten e nje shtrese te nje trajteshme te rrafshet, pastrimi dhe pregaditja per shtresat tjera	m ²	250.00	0.10 €	25.00 €
14	Furnizimi me material, patinimi I mureve dhe tavaneve me suvatim "MP75" - "pjeserisht" sipas nevojës ne dy shtresa. Aplikimi I mases MP75-uje sipas instruksioneve te prodhuesit. Llogarina ne m2 te tere hapesires se gletuar pjeserisht.	m ²	25.00	1.00 €	25.00 €
18	Furnizimi, transporti dhe Ngjyrosja e mureve dhe tavaneve te brendshme me ngjyrë speciale te nuancuar pikment ekologjike, neper vendet e caktuara ku kerkohej me rekomandime.Ngjyra dhe Nuanca percaktohet nga organi mbikqyres.	m ²	250.00	1.00 €	250.00 €



TOTALI - XI- (1-38)		2,271.00 €
---------------------	--	------------

RAKAPITULACIONI		
NR.	PËRSHKRIMI	VLERA TOTALE E ÇMIMEVE PËR NJËSI ME TVSH
I	ARKITEKTURA- PUNËT E DEMOLIMIT (1-129)	43.00 €
II	ARKITEKTURAPUNËT PËRGATITORE (1-22)	360.00 €
VI	ARKITEKTURA - PUNËT E MURATIMIT DHE PUNËT E PLLAFONIT (1-23)	1,170.00 €
VIII	ARKITEKTURA - PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT (1-11)	330.00 €
IX	ARKITEKTURA - PUNËT E DYSHEMESË (1-19)	2,023.46 €
XI	ARKITEKTURA - PUNËT E SUVATIMIT DHE FASADËS (1-53)	2,271.00 €
TOTALI I ÇMIMIT PËR TOTAL		6,197.46 €

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE - PARAMASA DHE PARALLOGARIA E RENOVIMIT TË OBJEKTEVE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS - - RENOVIMI I OBJEKTE TE FAKULTETIT TE SHKENCAVE - DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË					
Nr.	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI PËR TOTAL ME TVSH €
I PUNËT E DEMOLIMIT					
